VENDIM
Nr. 120, datë 17.2.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (CMIS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve, e quajtur CMIS.

2. CMIS-i administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato që grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash, të cilat përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- kërkesat për sigurim (numrin dhe datën);
- periudhën e siguruar (periudha, datat);
- shumën e derdhur e të vetësiguruarve.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato që merren nga baza të tjera të dhënash, të dhëna referenciare nga regjistri i Gjendjes Civile dhe regjistri i Tatimeve:

- numrin e identifikimit NID;
- emri;
- mbiemri;
- atësia;
- emri i nënës;
- datëlindja;
- vendlindja;
- mbiemri i vajzërisë;
- ZGJC_CODE;
- punëdhënësi;
- periudha e siguruar;
- shuma e derdhur.

5. Dhënës të informacionit janë:

a) qytetarët, përfitues të skemave;

b) drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;

c) Drejtoria e Tatimeve;

ç) baza e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

6. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të CMIS-it është, si më poshtë vijon:

a) Qytetarët kanë vetëm të drejtë të marrin informacion, duke patur mjet identifikimi;

b) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin, në rolet:

i) administrator;

ii) raportues;

iii) auditues;

iv) zhvillues.

c) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor, për të monitoruar apo për të raportuar.

7. CMIS-i ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së dhe të DPT-së vetëm me të dhënat parësore.

Proceset e punës në bazën e të dhënave të CMIS-it përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazën e të dhënave shtetërore".

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama